



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së tretë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i mbajtur më 21.06.2023.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave në Komunën e Prishtinës, e hapi mbledhjen e dytë, duke i përshëndetur të pranishmit, dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Në udhëheqjen e drejtorit Fushtica, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues komunalë, përfaqësues të këshillave të bashkësisë, përfaqësues të komuniteteve, përfaqësues të grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës etj.

Kryesuesi u shpreh se pjesëmarrja në këtë takim është privilegji për të.

Ai pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Kthimi i qytetarëve tanë me banim të përkohshëm në botën e jashtme, çështja e sigurisë dhe shërbimet administrative, informatë nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim;
4. Përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e komunës;
5. Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave, menaxhimi i situatës nga vërshimet e fundit dhe zhvillimi i aktiviteteve të tjera.
6. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit te procesverbalit të mbledhjes së dytë.

Hetem Kupina kërkoi që procesverbalit në të ardhmen t'i bashkëngjiten përgjigjet në kërkesat e bëra nga anëtarët e këshillit.

Njëzëri u miratua pika e parë.

Pika e dytë

Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Kryeqytet, informatë nga Policia e Kosovës.

Nimon Januzi, major, Stacioni Policor Qendra në Prishtinë, u shpreh se sa i përket Policisë lidhur me informatat për çështje të sigurisë që përfshihet Stacioni Policor Qendra, mund të themi se ajo është e qetë, nuk ka indikacione apo diçka që do të mund t'i ndanim me ju, si për institucionet ashtu edhe për qytetarët. Një raport i shkurtër mujor, ku paraqitet pasqyrimi i punës, angazhimi i punës policore, rastet e raportuara në stacionin policor. Gjatë këtij muaj kemi 2022 vepra penale, ngritje të zbulimeve penale 50%, kundërvajtje në trafik rrugor – 2015, 60 tiketa për rend dhe qetësi publike, ankesat për zhurmë nga lokalet, 58 urdhëresa të ndryshme të gjykatave dhe prokurorisë, 13 plane operative, ngjarje të ndryshme.

Dihet se kryeqendra ka shumë aktivitete të ndryshme, si vizita ndërkombëtare, lojëra sportive, aktivitete promovuese etj.

Kemi edhe asistim të gjykatave, projekte sensibilizuese, një ndër to është ruajta e pasurisë, në mënyrë që të kontribuojnë në këtë drejtim edhe qytetarët.

Nga niveli qendror kemi raste të raportimit të dhunës në familje, "stop drogat", mbrojtjen e natyrës nga rastet e zjarrit, ku kemi përgatitur fletushka të ndryshme dhe i kemi shpërndarë tek qytetarët, pak a shumë ato orientime që duhet të jenë në këto pika që i trajtova; po në të njëjtën kohë mënyrën e raportimit dhe kontaktet më të lehta me qytetarët, me polisinë dhe institucionet tjera relevante.

Në përgjithësi, jemi duke punuar që t'i trajtojmë kërkesat e qytetarëve, raportimeve të ndryshme, edhe pse shumica e tyre nuk kanë të bëjnë me ne, por prapë përpinqemi të bëjmë një zgjidhje duke i drejtar tek organet përgjegjëse.

Kemi bashkëpunim të mirë me institucionet e Komunës, siç janë: Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Arsimit etj.

Kemi organizuar edhe ligjërata në shkolla për projekte sensibilizuese dhe vetëdijesuese për nxënës. Ky është një raportim në pika të shkurtra. Në çoftë se ka dikush pyetje mund të komentohen.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave të Kryeqytetit, theksoi se në kryeqendër kemi pasur aktivitete të shumta dhe do të vazhdojmë me aktivitete të tjera, që ishin në koordinim, dhe do të jenë shumë të rëndësishme në arritjen e objektivave të dyanshme.

Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni Policor Veriu, në Prishtinë, theksoi se gjendja në territorin që e mbulon ky stacion është stabile dhe nuk ka indikacion për prishjen e gjendjes. Ajo i falënderoi qytetarët apo banorët, përfaqësuesit e komuniteteve dhe aktorët partnerë në avancimin e sigurisë. Sa i përket veprave, 26% kemi rritje në veprat penale, tek armët 200% dhe drogat 30%. Gjithashtu, kemi rritje të gjobave në trafik 30%, aksidente 30% dhe urdhëresa 30.6%. Kohët e fundit kemi pasur reshje shiu në disa fshatra, andaj e falënderoj drejtorin për Siguri dhe Emergjencën për bashkëpunimin. Ky është një raport i shkurtër.

Naser Sinani, kapiten, Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, theksoi se situata e përgjithshme është e qetë dhe e qëndrueshme. Sa i përket angazhimeve profesionale, është ngritur niveli i zbulimeve të veprave penale, të kapaciteteve hetuese, zyrtarëve me rroba civile. Në raportin e muajit janar kemi pasur 2319 raste, prej këtyre rasteve 1477 kanë qenë penale, 142 aksidente, janë shqiptuar 5820 tiketa për kundërvajtje të ndryshme në komunikacion, kemi pasur 31 sulme nga qentë endacakë, si dhe 132 kundërvajtje për prishjen e rendit dhe qetësisë, 521 urdhëresa të Gjykatës apo Prokurorisë, si dhe janë 5 plane operative në shkolla, trafik, rastet e vjedhjeve etj.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave të Kryeqytetit, hapi diskutimin.

Kthimi i qytetarëve tanë me banim të përkohshëm në botën e jashtme, çështja e sigurisë dhe shërbimet administrative, Informatë nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim.

Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni Policor Veriu në Prishtinë, tha se gjimnazi "Ahmet Gashi" i përket Stacionit Veriu, dhe kemi informata për dy rastet, për çka janë janë marrë të gjitha procedurat sipas ligjit.

Klaudija Mula, zyrtare e Zyrës për komunitete dhe kthim, theksoi se kjo zyrë merret me çështjet e përgjithshme për komunitet. Sa i përket kësaj pike, më e përshtatshme do të ishte prezenca e drejtorit të Administratës. Unë do të përpinqem t'i dha disa informata të përgjithshme. Gjatë kësaj kohe janë bërë disa përgatitje për mërgimtarët si çdo vit në sezonin e verës, jemi angazhuar që të gjitha Bashkësitë lokale të janë në shërbim dhe me orare të shtuar. Gjithashtu, kemi kërkuar edhe parking pa pagesë. Ne do të jemi në asistencë familjeve, kemi bashkëpunim me Policinë dhe KFOR-in dhe kemi kërkuar nga policia shtimin e masave.

Nimon Januzi, major, Stacioni Policor Qendra, në Prishtinë, theksoi se kërkesa e drejtoreshës për sezonin veror, të kemi plane operative në terren dhe sheshe. Shërbimet administrative punojnë vazhdimisht deri në orën 16:00, me kapacitet të shumta. Si polici jemi të organizuar dhe kemi bashkëpunuar, i kemi planifikimet, i përfundojmë në kohë me Komunën dhe me qytetarët në përgjithësi.

Artur Krasnqi, Kisha Protestante, bëri pyetje për z. Mulaj, lidhur me rastin e riatdhesimit të qytetarëve tanë, a është dikush që e koordinon kthimin e tyre.

Unë di shumë raste ku shtetet, si Suedia, Gjermani, Zvicra etj. gjatë kohës kur riatdhesohen qytetarët tanë në Kosovë, zakonisht policia i përcjell deri në aeroporte, policia i pyesin a keni ku të shkoni, por kush merret me ta pastaj këtu te ne. A ekziston një mekanizm që tregon për këta njerëz çka ka ndodhur, kur kthehen a futen në sistem të kontrollit në vendin tonë, apo vetëm iu urohet mirëseardhje në Kosovë, po nuk dimë asgjë, qoftë për të kaluarën e tyre, qoftë çka bëjnë në Kosovë tash e tutje, pse i ka kthyer shteti ku kanë

qëndruar, nuk bartet lënda e tyre në këtë vend. Andaj unë desha të dijë se si është kjo e organizuar dhe si funksion.

Klaudija Mula, zyrtare nga Zyra për komunitete dhe kthim, falënderoi parafolësin për pyetjen, duke thënë se kjo pyetje ka të bëj me riatdhesimin. Në momentin që ata kthehen në aeroportin e Prishtinës, i marrin të gjitha informatat lidhur me ta. Kërkesën e tyre e shqyrton Komisioni komunal për integrim në Komune e Prishtinës, i cili e merr, së bashku me dokumentacionin e personit në fjalë dhe i dërgon në Ministrinë e Punëve të brendshme për të shqyrtuar kërkesën dhe atje merret vendimi.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave të Kryeqytetit, theksoi se edhe unë mund të flas për këtë çështje sepse kam punuar në fushën e sigurisë.

Nimon Januzi, major, Stacioni Policor Qendra në Prishtinë, njoftoi se për kthimin e të riatdhesuarve, sa i përket policisë, në ato raste është mënyra e trajtimit, përndryshe, qofte më kërkesë ose nuk i plotësojnë kriteret për vendqëndrim, atje është e njëjtë procedurë që e përmendi.

Përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e komunës.

Fexhri Hyseni, përfaqësues nga Drejtoria e Bujqësisë, bëri të ditur se sa i përket korrjes në muajin korrik varet nga faktorë të ndryshëm klimatikë, sidomos reshjet kanë ndikuar në bujqësi, ku si pasojë janë paraqitur disa sëmundje. Planifikojmë formimin e komisionit për vizitat në terren dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Bujqësisë, buxheti është 400 mijë euro për fermerët, 980 hektarë të mbjella, gjendja autokombajnave nuk është e kënaqshme, por falë bashkëpunimit është shndërruar në një traditë. PO përpinqemi që humbjet të janë sa më të vogla. Korrja për këtë vit do të jetë 120 euro për hektar. Në rast se do të ketë reshje, atëherë kjo do të ndikojë dhe do të ketë sëmundje të ndryshme.

Malë Gashi, Brigada e zjarrfikësve, premtoi se do të merren të gjitha masat dhe do të bashkëpunojmë me policinë. Ai u shpreh se kam një pyetje për masat që do të ndërmerren pas përfundimit të korrje-shirjeve.

Fexhri Hyseni, Drejtoria e Bujqësisë, tha se nuk kemi masa, por kemi vetëm komunikim me fermerët.

Xheladin Fazliu tha se numri i pjesëmarrësve në xhamia është i madhe , bashkëpunim me liderët fetarë për informim dhe shfrytëzimin për ndarje të informacioneve.

Malë Gashi - Masat për të nxjerrë një vendim për bujqit, t'i kenë traktorët, aty për aty të merren për ndonjë rast.

Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave - Menaxhimi i situatës nga vërshimet e fundit dhe zhvillimi i aktiviteteve të tjera.

Lulzim Fushtica, drejtor, Theksoi se kjo është drejtori e re, por kemi zhvilluar aktivitete të shumta, për çka e falënderojmë Policinë e Kosovës, Brigadën e zjarrfikësve dhe KFOR-in., të përfshira në aktivitete, inspektimi në shkolla, duke bërë analizimin dhe vlerësimin në aspektin e hapësirave publike etj. Kemi plane të shumta që pritet të realizohen, inspektimi dhe bashkëpunimi me drejtoritë tjera, si p.sh. me Drejtorinë e Shëndetësisë. Kemi pasur intervenime në fshatra, ku do të kompensohen qytetarët për dëmet nga të reshurat. Kompania slovene do të na ndihmojë për lumin Llap, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Investimeve Kapitale.

Malë Gashi tha se është bërë shumë mirë që është themeluar Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave. Është me rëndësi të aktivizojmë dhe bashkëpunojmë me sektorin privat.

Muhamed Reqani, Brigada profesionale e zjarrfikësve, bëri të ditur se te shfaqja e zjarreve kemi 31% rënie, intervenime në aksidente, 25% reshje, 9% shërbime, 15% zjarre nga viti i kaluar, veturat 18% , pajisjet elektrike 46% rënie.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, theksoi se në fshatin Shkabaj dhe tek Stacioni i autobusëve kemi pasur dy raste dhe kemi shpëtuar edhe jetë të njerëzve. Nga muaji shkurt kryetari ka shpallur gjendje emergjente për qentë endacakë, kemi pranuar ankesa të shumta, ku kemi hapur 24 pika, kemi filluar me kapjen e tyre. Kemi një strehimore të licencuar, qëllimi është të vetëdijesohen qytetarët. Qëllimi nuk është keqtrajtimi i kafshëve, andaj ftoj edhe aktivistët dhe organizatat në projektet.

Të ndryshme.

Armend Ahmeti tha se rruga "Skënderbu" është duke u rregulluar, komunikacioni është i ngarkuar, shenjëzimi, bllokimi dhe trafiku urban janë disa nga brengat, andaj pyes se kur do të përfundojnë punimet në këtë rrugë.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave premtoi se këto shqetësime të paraqitura do t'i përcjell tek drejtoritë përkatëse.

Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni Policor Veriu në Prishtinë, bëri të ditur se ka kontaktuar me imamin e xhamisë, të cilit i është kërkuar që të mos e bllokojnë hyrjen e Stacionit të policisë dhe Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave tha se e kuptoj shqetësimin tuaj, por drejtoritë janë duke punuar për zgjidhjen e problemit.

Gentian Osmani ceku disa nga shqetësimet, duke cekur kontrollimin e veprimitarive afër shkollave, shpejtësia e makinave, patrullimi i policëve afër objekteve shkollore, zhurmat e ndryshme etj., të gjitha këto janë shqetësime për fëmijët në shkolla.

Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave tha se shqetësimin tuaj do ta përcjell tek inspeksioni, ndërsa çështjet tjera janë të Policisë.

Melihate Sefedini, kapitene, Stacioni Policor Veriu në Prishtinë, premtoi se do të merren masat e duhura për këtë.

Procesmbajtësja

Agnesa Krasniqi

Kryetari i Komunës

Përparim Rama

